



Datë: 16.05.2025  
Numër Protokolli: 3241/2025

A.nr.542/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi- Bajraktari-anëtarë, me Rushit Kajtazi - në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 542/2025 të datës 25.03.2025 të parashtruar nga ankuesi S.K, kundër organit të punësimit Komuna e Gjilanit në çështjen juridike “*vlerësim i rezultateve në punë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 16.05.2025 mori këtë;

## V E N D I M

**I. Aprovohet** si e bazuar ankesa me numër A.nr. 542/2025 e datës 25.03.2025 e parashtruar nga ankuesi S.K.

**II. Ndryshohet** Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë i datës 21.02.2025 për periudhën e vlerësimit gjatë viti 2024 lidhur me notën e përgjithshme të vlerësimit për ankuesin dhe atë nga “ka nevojë për përmirësim”, bëhet “**arrin pritshmëritë**”.

**III.** Ky vendim zëvendëson Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në Punë për ankuesin si në pikën II të dispozitivit dhe i njëjti duhet të përfshihet në dosjen personale dhe regjistrat përkatës të nëpunësit civil.

**IV.OBLIGOHET** Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit, që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimin të tij.

**V.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## **A r s y e t i m**

Nëpunësi civil, S.K tutje referuar vetëm ankuesi), më datë 22.05.2025 përmes postes, ka parashtruar ankesë, e cila ankesën është pranuar me datë 25.03.2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularit të datës 21.02.2025 për vlerësimin e rezultateve në punë nga Drejtoresha e Drejtorisë për Inspektion në Komunën e Gjilanit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 27.03.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Gjilanit, ndërsa kjo e fundit me datë 03.04.2025 ka kthyer përgjigje në ankesë me shkresat e lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave** (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën e parashtruar nga ankuesi drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollit 1978/2025 të datës 25.03.2025; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 21.02.2025; Raporti i Punës për vitin 2024; Vendimi A.nr.323/2023, i datës 06.04.2023, i Këshillit; Vendimi A.nr.289/2023, i datës 30.04.2023, i Këshillit; Vendimi A.nr.17/2023, i datës 20.02.2023, i Këshillit; Vendimi A.nr.1591/2024 i datës 06.12.2024, i Këshillit; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 27.03.2025, dërguar nga R.K, për B.K, përmes emailit; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 542/2025, e datës 07.04.2025; Akt Emërimi me numër protokollit 51840, i datës 01.07.2020, për ankuesin S.K; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën ‘‘ Udhëheqës i Sektorit të Inspektiveve’’; emali i datës 19.02.2025, dërguar nga S.K, për E.H; emali i datës 20.02.2025, dërguar nga S.K, për E.H; Plani i Punës për vitin 2024; Raporti i punës për muajin Janar të vitit 2024; Raporti i punës janar dhjetor i vitit 2024, për S.K.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse*,

Nga administrimi i provave të lëndës, rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Komunën e Gjilanit, sipas Akt Emëritit me numër protokollit 02-16, të datës 01.07.2020, në pozitën Udhëheqës i Sektorit për Inspektive’’. në Drejtorin e Inspektionit.

Më tej nga shkresat lëndës Kolegji ka gjetur së Drejtoresha e Drejtorisë e Inspektionit, në cilësi të mbikëqyrëses së drejtpërdrejt të ankuesit, me datë 21.02.2025 ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2024, lidhur me vlerësimin e përgjithshëm e ka vlerësuar me nivelin ‘‘**ka nevojë për përmirësim**’’.

Kolegji ju referua Ligjit Nr.8/L-197 për Zyrtarët Publik gjegjësisht Neni 52 paragrafi 1,2,3 nën paragrafi 3.1, 3.2, 3.3 si dhe paragrafit 4,5,6 nën paragrafit 6.1,6.2 dhe paragrafit 11 ku përcaktohet se ‘‘Vlerësimi i rezultateve në punë 1. ***Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i vazhdueshëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuara, vlerësimin e aftësisë profesionale,***

*metodologjike, personale dhe sociale të nëpunëses/it civil në realizimin e objektivave dhe përmbushjen e përgjithshme të përgjegjësisë të njësisë. 2. Periudha e vlerësimit zgjat një (1) vit, nga 1 janari deri me 31 dhjetor. Procedura e dhënies së vlerësimit përfundon deri më 28 shkurt të vitit pasues. 3. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në: 3.1. realizimin e objektivave të përcaktuara në planin vjetor individual, përmbushjen e detyrave të punës në përputhje me përshkrimin përkatës të punës, objektivat e njësisë dhe institucionit, si dhe kryerjen e detyrave të atypëratyshme që nuk janë*

*paracaktuar paraprakisht apo nuk kanë mundur të paracaktohen; 3.2. aftësitë profesionale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe sjelljen profesionale; 3.3. aftësitë metodologjike, personale dhe sociale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës. 4. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunëses/it civil bëhet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësen/in dhe përfaqësuesen/in e njësisë së burimeve njerëzore, me shkrim, në muajin janar të çdo viti, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave. 5. Plani individual i punës i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni, mund të rishikohet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me nëpunësen/in civil. 6. Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë përfshin dy (2) faza kryesore: 6.1. mbikëqyrjen e vazhdueshme të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë; 6.2. vlerësimin vjetor të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore. 11. Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë gjatë procesit të vlerësimit është e/i obliguar të vlerësojë nëpunësen/in në mënyrë objektive dhe të argumentojë vlerësimin.*

Duke marr parasysh dispozitat e cekura si më lartë, dhe po ashtu duke marr parasysh provat materiale të lëndës, konkretisht Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të datës 21.02.2025 për ankuesin i cili është vlerësuar në nivelin “Ka nevojë për përmirësim” është vlerësim që tregon se nëpunësi civil nuk ka arritur të përmbushë në mënyrë të plotë pritshmërinë dhe kërkesat për rolin e saj. Ekzistojnë fusha ku kërkohet përmirësim i dukshëm për të arritur nivelin e pritshëm të performancës, të bashkangjitura në provat e lëndës kemi vendimin A. nr.289/2024, të datës 30.04.2024, përmes të cilit vendim Këshilli ka aprovuar ankesën e ankuesit si të bazuar ashtu që ka ndryshuar Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 20.02.2024, lidhur me notën e përgjithshme nga pika një pikë nëntëdhjetë tre (1.93), kënaqshëm mjaftueshëm në tre pikë një (3.1), mirë, për vitin 2023, si dhe vendimi A. nr. 323/2023, të datës 06.04.2023, përmes të cilit vendim Këshilli ka aprovuar ankesën e ankuesit si të bazuar duke e obliguar Drejtoreshën e Drejtorisë së Inspektionit në Komunën e Gjilanit, që në afatin prej 15 ditëve nga dita e pranimi të këtij vendimi ti ndërmerr të gjitha veprimet me qëllim që ankuesit t’i bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2022, për periudhën se ankuesi ka qenë në varësi të saj, çka rezulton se ka arritur të përmbush të gjitha objektivat e përcaktuara të punës.

Po ashtu Kolegji i Këshillit, me qëllim të analizimit të kategorizimit apo ndarjes së notave të vlerësimit për arritshmëri të rezultateve në punë, analizoi dispozitat e nenit 52 paragrafi 13, 15, dhe 17 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *“Nivelet e vlerësimit të rezultateve në punë janë: 13.1. arritje e jashtëzakonshme; 13.2. tejkalon pritshmëritë; 13.3. arrin pritshmëritë; 13.4. ka nevojë për përmirësim; 13.5. e papranueshme, 15. Në rastin e vlerësimit në nivelet sipas paragrafit 13, nënparagrafit 13.4. dhe 13.5. përpos trajnimeve të detyrueshme, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me NjMBNj-në e institucionit, vendos që nëpunësja/i civil i nënshtrohet një vlerësimi të*

*veçantë. 17. Nëpunësja/i civil e cila nuk është e kënaqur me vlerësimin si në paragrafin 13. nënparagrafit 13.4. dhe 13.5. të këtij neni, ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHCK, sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative”* dhe erdhi në përfundimin se Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë vetëm për dy lloje të vlerësimit e ka lejuar ankimin pranë Këshillit, respektivisht për vlerësimin *“ka nevojë për përmirësim”* dhe vlerësimin *“e papranueshme”* e që në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit sipas ligjit të ri, vlerësimi *“ka nevojë për përmirësim”* dhe vlerësimi *e papranueshme* është ekuivalent me vlerësimin *“kënaqshëm ose mjaftueshëm”* apo vlerësimin *“jo kënaqshëm ose jo mjaftueshëm”* i përcaktuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Po ashtu, nga shkresat e lëndës të ofruara nga institucioni, konstatohet se ankuesit i është bërë vlerësimi për periudhën janar –dhjetor të vitit 2024. Gjatë kësaj periudhe ankuesi ka përgatit raportin e punës për 12 muaj prej muajit janar-dhjetor 2024 të cilin e posedojmë në provat e lëndës ku vërtetohet se: është bërë ofrimi i shërbimeve cilësore që është kërkuar në drejtori, numri i inspektimeve treqind e katër dhjetë 340, numri i procesverbaleve të hartuara në terën dyqind e nëntë dhjetë 290, numri i gjobave të shqipëruara shtatë 7, pranime teknike njëqind e shtatëdhjetë e nëntë 179, shuma e parave të hyra nga pranimit teknik 20.750.00 €, mbyllje të subjekteve një 1, të hyra nga gjoba 1.350.00€, Njoftime Aktvendime të pranuar nga MMPHI, gjatë 6, Numri i procesverbaleve njëqind e pesëdhjetë e pesë 155, numri i kërkesave të dorëzuara në Gjykatën Themelore në Gjilan zero, Numri i shqiptimit të gjobave mandatore shtatëmbëdhjetë 17, Numri i kërkesave zyrtare të pranuar njëzet e pesë 25, Numri i kërkesave zyrtare të shqyrtuara njëzet e pesë 25, numri i kërkesave në shqyrtim zero, Numri i procesverbaleve njëqind e shtatëdhjetë dy 172, Numri i kundërvajtjeve gjashtëmbëdhjetë 16, numri i gjobave mandatore tridhjetë e tetë 38, numri i konstatimeve shtatëdhjetë e katër 74, Numri i vërejtjeve për transport të mallit shtatëmbëdhjetë 17, Numri i vërejtjeve për taksitëmbëdhjetë 18, numri i kërkesave të pranuar gjashtë 6, numri i kërkesave të shqyrtuara gjashtë 6, numri i kërkesave që janë në shqyrtim zero, numri i rekomandimeve DSHPIB-së dy 2, Numri i inspektimeve dyqind e gjashtëdhjetë e katër 264, numri i inspektimeve me procesverbal njëqind e tridhjetë e katër 134, numri i konstatimeve shtatëdhjetë e një 71, Numri i vërejtjeve gjashtëdhjetë e shtatë 67, numri i gjobave nëntë 9, numri i largimeve pesë 5, numri i kërkesave të pranuar njëzet e tetë 28, Sfera e ndërtimit, procesverbale katërqind e dhjetë 410, përgjigje ndaj kërkesave treqind e gjashtëdhjetë 860, përgjigje ndaj ankesave njëzet e një 21, lejet e pranuar nga DUPMM, njëqind e njëmbëdhjetë 111, aktvendimeve për ndërprerje nëntë 9, vendime për rrënimë tetë 8, kallëzime penale tetë 8, gjoba katërmëdhjetë 14, procedimi i lëndës për mos pagës dy 2, , Nga shkresat e lëndës nuk konstatohet ndonjë dëshmi se mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë i ka dhënë ndonjë

*sugjerim apo kërkesë se ankuesit se nuk ka përmbushë ndonjë detyrë për kohën e vlerësuar; prandaj Kolegji ka ardhë në përfundim se vlerësimi i ankueses në nivelin ka “**nevojë për përmisim**” është bërë*

*në mënyrë subjektive pa argumente dhe dëshmi të mjaftueshme, andaj Kolegji i Këshillit ka konstatuar se udhëheqësja e ankueses nuk i ka përmbushur obligimet ligjore sikurse përcaktohet me nenin 9 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr. 26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë ku përcaktohet se: “6. Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesi i NjMBNj-së, e zhvillojnë takim me nëpunësin për vlerësimin e rezultateve të punës. Pas takimit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë aprovon formularin e vlerësimit që e nënshkruajnë të gjitha palët”. Nga shkresat e*

*lëndës nuk konstatohet ndonjë dëshmi se mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë i ka dhënë ndonjë sugjerim apo kërkesë se ankuesi nuk ka përmbushur ndonjë detyrë për kohën e vlerësuar, prandaj Kolegji ka ardhë në përfundim se vlerësimi i ankueses në nivelin ka “**nevojë për përmisim**” është bërë në mënyrë subjektive pa argumente dhe dëshmi të mjaftueshme.*

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
*Lënda me numër A.nr.542/2025*

**Rushit Kajtazi**

Procesmbajtës

**Eshref SHABANI**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit S.K;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.